



---

## Asociacioni i Komunave të Kosovës

### RAPORT

nga

Takimi i Kolegjiumit për Financa dhe Buxhet

**Prishtinë, 17 maj 2011**

---

**Për:** Ertan Munoglu – Menaxher i Programit i AKK-së

**Nga:** Fisnik Dashi – Koordinator i Kolegjiumeve të AKK-së

**Lënda:** Raport nga takimi i Kolegjiumit për Financa dhe Buxhet



## HYRJE

Asociacioni Komunave të Kosovës (AKK) në bashkëpunim me Kryesinë e Kolegjiut për Financa dhe Buxhet organizoi takim të parë të këtij Kolegjiut për këtë vit më 17 maj 2011 (e martë) me fillim nga ora 11:00 në Restorantin 'Villa Gërmia' në Prishtinë.

Takimi kishte për qëllim të diskutohej rendi i ditës i përcaktuar më parë nga Kryesia me këto pika:

- Plotësimi i Kryesisë së Kolegjiut,
- Përpilimi i Planit të Punës për vitin 2011,

Në këtë takim morën pjesë Drejtorët për Financa dhe Buxhet nga Komunitat e Kosovës. Po ashtu ishin prezent edhe znj. Qamile Ramadani, zyrtare në DFID, si dhe përfaqësues të AKK-së. Takimi u kryesua nga Kryesuesja e Kolegjiut për Financa dhe Buxhet, znj. Afërdita Grapci.

## PËRMBLEDHJE

### ➤ Plotësimi i Kryesisë së Kolegjiut

znj. Grapci: informoj të pranishmit me qëllimin e takimit duke sqaruar se duke marrë parasysh mos pjesëmarrjen e anëtarëve në takimet e Kryesisë, në këtë mbledhje pritet të diskutohet dhe kompletohet përbërja dhe organizimi i punës së Kryesisë së Kolegjiut. Po ashtu Kolegjiut do duhej të diskutonte prioritetet dhe përpilimin e Planit të Punës së Kolegjiut për vitin 2011. Në këtë vijë të ketë edhe një pjesëmarrje më aktive në takimet e ardhshme të Kryesisë dhe kolegjiut.

z. Fikri Verbani, zv. kryesues: sugjeroj që të ketë një fokusim më të madh në punën e mëtutjeshme dhe angazhimit të drejtorëve. Duhet të shqyrtojmë planin e punës në përcaktimin e prioritetëve dhe objektivave të cilat do të arrijmë në këtë Kolegjiut. Nëse drejtorët janë të angazhuar me punë tjera është mirë të delegojnë një përfaqësues të tyre në takimet e ardhshme të Kolegjiut me qëllim që të njoftohen me ecurinë e punës. Do të ishte mirë që në takimet e Kolegjiut po ashtu të ftohen edhe zyrtarët nga Ministria e Financave për diskutim për çështje konkrete.

z. Ertan Munogu, Menaxher Programi në AKK: shtoj se ky takim është i pari për këtë vit për këtë Kolegjiut, prandaj është mirë që të diskutojmë planin e punës si një udhëzues i efektshëm në punën e mëtutjeshme.

znj. Grapci: Do të ishte mirë të plotësojmë Kryesinë me anëtarë të cilët do të jenë më aktiv dhe përgjegjës në punën sipas agjendës së paraparë. Është mirë të deklarohen të gjithë ata anëtarë të cilët për shkak të angazhimeve të tyre nuk dëshirojnë të marrin pjesë në Kryesi.

z. Eroll Raskova, zyrtar për buxhet dhe financa – Prishtinë : do të ishte mirë të dimë se sa veta do të jenë anëtarët të cilët do të zgjedhim në Kryesi dhe cilët prej tyre nuk kanë qenë aktiv deri më tash që të mos i propozojmë të njëjtit.

z. Gani Mustafa, drejtor për buxhet dhe financa – Novobërdë: le të zgjedhim ata persona të cilët do të shprehin dëshirën dhe vullnetin për angazhim në punën e Kolegjiut, njëkohësisht të deklarohen edhe ata persona në Kryesi të cilët dëshirojnë apo nuk dëshirojnë të vazhdojnë punën e tyre.

z. Mustafë Grainca, drejtor për buxhet dhe financa - Ferizaj: deri më tash kjo Kryesi ka dështuar në punën e saj, atëherë është me rëndësi që të zgjedhën njerëzit të cilët premtojnë se do të jenë aktiv dhe të interesuar për punë.

znj. Grapci: Duke ditur se procesi i planifikimit buxhetor është një proces shumë i rëndësishëm, ftoj që të ketë një angazhim më të madh prej të gjitha palëve në këtë proces. Qëllimi i punës tonë është të bëjmë përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të tërë komunave të Kosovës, andaj propozoj që numri i anëtarëve të Kryesisë të shtohet në 9 veta në mënyrë që të ketë një përfaqësim më të gjerë.

z. Munoglu: shtoj se do të jetë vetë Kolegjiut ai i cili do të shtyjë proceset përpara, ndërsa roli i AKK-së është vetëm të mbështesim këto procese të rëndësishme. Është vendim i Kolegjiut për anëtarësinë e Kryesisë, mirëpo numri më i madh i Kryesisë mund të shkaktoj pengesa në arritjen e kuorimit të Kryesisë.

Kryesuesja në vazhdim ftoj pjesëmarrësit të votojnë, dhe si përfundim me shumicë votash u miratua që Kryesia e kolegjiut për Financa dhe Buxhet tash e tutje të përbëhet prej 9 anëtarëve, si vijon:

1. Afërdita Grapci – Pejë (Kryesuese)
2. Fikri Verbani – Kaçanik (zv. Kryesues)
3. Ramadan Jashanica - Fushë Kosovë
4. Sabri Qerkini - Shtime
5. Eroll Raskova - Prishtinë
6. Vesel Krasniqi - Malishevë
7. Ljubomir Pržic - Klllokot
8. Nuhi Nuhiu - Gjilan
9. Isuf Latifi – Podujevë.

#### ➤ **Përpilimi i Planit të Punës për vitin 2011**

z. Munoglu: në shpjegimin për planin e punës tha se është planifikuar të ketë dy prioritete për këtë vit pasi që angazhimi në shumë prioritete shkakton shtrirje në fushëveprim dhe si pasojë shkakton mos përmbushje të detyrave të përcaktuara më herët. Po ashtu sqaroi edhe strategjinë legjislativë, bisedimet me zyrën ligjore të Kryeministrit dhe Ministrive për punët në grupet punuese rreth projektligjeve të reja.

znj. Grapci: tha se duke marrë parasysh rëndësinë e punës dhe problemet të cilët kanë drejtorët për buxhet dhe financa, duhet të rishikohet nëse është e nevojshme përcaktimi i më tepër se dy prioritete për planin e përgjithshëm të punës.

Pas diskutimeve dhe debatit, Kryesia vendosi për këto prioritete dhe objektiva në realizimin e planit të punës së Kolegjiumit për Buxhet dhe Financa në vitin 2011.

- **Prioriteti parë : Funkcionalizimi i Kolegjiumit** duke pasur për objekteve kompletimin e Kryesisë dhe efikasitetin e Kolegjiumit
- **Prioriteti i dytë: Procesi buxhetor** duke pasur për objektivë rishikimin e buxhetit 2011 dhe planifikimin e buxhetit 2012-2014.
- Si pjesë integrale e Planit të punës është identifikuar edhe nevoja për trajnim 2-3 ditorë mbi Pasqyrat financiare, i cili do të mund të mbahej nga AKK në bashkëpunim me Ministrinë e Financave në nëntor/dhjetor 2011.

Në takim po ashtu u ngritën edhe disa çështje tjera të cilat nuk ishin paraparë me agjendë, si vijon:

- alokimi i mjeteve nga gjocat e trafikut në bazë të kodeve bankare të cilat bëjnë që këto mjete të shkojnë në komuna të cilat nuk kanë dhënë ato gjoca (z. Valon Prestreshi, drejtor për buxhet dhe financa - Obiliq)
- mos alokimi mjeteve për mirëmbajtje të objekteve të reja të cilat ndërtohen (z. Agron Demukaj, drejtor për buxhet dhe financa – Deçan)
- respektimi i ligjit për auditim të brendshëm në komuna dhe ngritja e pagave të stafit politik komunal (z. Ahmet Bahtijari, drejtor për ekonomi dhe financa – Dragash)
- decentralizimi fiskal nëpër shkolla shkakton probleme për shkak të mungesës së kapacitetit menaxhues (z. Xheli Bektashi, drejtor për financa – Prishtinë).

z. Vërbani: takimet e ardhshme të mbahen sipas planit, por gjithsesi plani mund të rishikohet varësisht nga qarkoret buxhetore. Nëse është e nevojshme mund të mbajmë edhe mbledhje urgjente për të dhënë rekomandimet tona për këto çështje.

Më pas znj. Grapci i dha fjalën znj. Qamile Ramadani nga projekti i DFID-it për prezantimin e programit për decentralizimin financiar dhe administrativ të shërbimeve të kujdesit social.

znj. Ramadani sqaroi qëllimin e programit të DFID-it i cili do të mbështes zhvillimin e kapaciteteve të Kolegjiumeve për të koordinuar dhe lehtësuar dialogun politik në lidhje me shërbimet sociale për njerëzit në nevojë. Përfitues të këtij projekti do të jenë MPMS, MAPL, MEF, AKK me Kolegjiumet relevante. Në nivel lokal përfitues janë Drejtoritë Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Drejtoritë për Buxhet dhe Financa dhe Qendrat për Punë Sociale.

Rezultati pritet të jetë kapaciteti i zhvilluar i Qeverisë së Kosovës për të planifikuar dhe menaxhuar shpenzimet publike dhe shërbimet e kujdesit social.